

Kërkesat e Krediteve të Nevojshme për Diplomimin nga Shkolla e Mesme

Nxënësi do të diplomohet nëse ai, ose ajo fiton një total prej 23.5 kreditesh, që përfshijnë:

- 4 kredite në Anglisht
- 3 kredite në Matematikë
- 3 kredite në Shkencë
- 3 kredite në Studime Sociale
- 1 kredit në Historinë Afrikano- Amerikane
- 2 kredite në Gjuhë të Huaj
- 2 kredite në klasa të Artit dhe Humanitetit
- 1 kredit në Edukim Fizik
- 0.5 kredit në Edukim Shëndeti
- 4 kredite në fusha të ndryshme me zgjedhje
 - 1 lëndë e zgjedhur duhet të jetë nga këto fusha: Matematikë, Shkencë, Baçelor Ndërkombëtar (International Baccalaureate), ose kurse të Klasave të Përparuara. Shkollat me Pranim Special, ose programet dhe shkollat me kërkesa pranimi, mund të përcaktojnë lëndët me zgjedhje, si një kërkesë në matematikë, shkencë, ose të tjera.
- Të plotësojnë me sukses një Projekt Gjithëpërfshirës të lëndëve, ose një Projekt Mësimor.

Kreditet për secilën lëndë, ose klasë quhen të marra, nëse nxënësi merr notën D ose më lart.